



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 211/4 Prot.

Tiranë, më 28/3 /2017

REKOMANDIM

Nr. 05 datë 28/3 /2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*",

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 33 datë 06/02/2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Fondacioni "*Zoja e Këshillit të mirë*" – Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*", me objekti kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Fondacioni "*Zoja e Këshillit të mirë*" – Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*".

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin nr. 33 datë 06/02/2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*" ushtron aktivitet në arsimin universitar nëpërmjet katër fakulteteve të ndryshme si ai i Mjekësisë, Farmacisë, Ekonomisë dhe Shkencave të Aplikuara.

Kontrolluesi Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*", përpunon të dhëna personale kryesisht për subjektet e dhënave "*punëmarrës*", "*studentë*" dhe "*vizitorë*". Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër) si dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të tilla si sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), portali i studentit, portali zyrtar i institucionit, pajisje kompjuterike etj.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vend, është konstatuar se:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale por konstatohet se duhet bërë përditësimi i deklarimit në mënyrë të menjëhershme.  
Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të ligjit - "1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.";
2. Kontrolluesi ka vendosur tabela informuese mbi prezencën dhe monitorimin e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), por këto tabela nuk janë në përputhje me modelin standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi nuk ka publikuar në portalin zyrtar <http://www.unizkm.al>, "Politikat e Privatësisë" në lidhje me të dhënat të cilat mblidhen nëpërmjet këtij portali.  
Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit - "1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit..."

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin dhe e lexoi në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët nuk paraqitën pretendime.

Kontrolluesi Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit shkresën nr. 211/2 Prot. datë 17/02/2017 duke bërë sqarimet si më poshtë vijon:

1. Për konstatimin e parë, brenda ditës përditësuam formularin e njoftimit, të cilin ja bashkëlidhim këtij akti. Sqarojmë se kjo detyrë u vu nga grupi i hetimit administrativ, pasi në dhjetor 2016 "Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë", në zbatim të detyrimeve ligjore (ligji nr. 19/2016 datë 10/03/2016 "për masat shpesh të sigurisë publike" i kërkoi kompanisë së sigurimit dhe në bashkëpunim me të kontraktuan dhe vendosën sistemin e kamerave të vëzhgimit. Ky sistem përfundoi nga kompania e kontraktuar në janar 2017. Vendosja e sistemit të kamerave na detyron ne dhe kompaninë e sigurisë të njoftonim Zyrën e drejtuar nga Ju dhe, mbi këtë bazë zbatuam detyrimin e grupit të hetimit administrativ duke bërë përditësimin e formularit të njoftimit (me një vonesë nga momenti i instalimit të kamerave disaditore).
2. Për konstatimin e pikës së dytë se tabelat informuese nuk janë në përputhje me modelin standard të miratuar me udhëzimin nr. 3/2010 të Komisionerit, sqarojmë se këto tabela janë vendosur nga kompania që montoi sistemin e kamerave, megjithatë nga ana jonë u vendos të ndërrohen të gjitha tabelat sipas standardit të rekomanduar nga ana juaj.
3. Për sa i përket konstatimit të tretë se Kontrolluesi nuk ka publikuar në portalin zyrtar [www.unizkm.al](http://www.unizkm.al) "Politikat e Privatësisë" në lidhje me të dhënat të cilat mblidhen nëpërmjet këtij portali, sqarojmë se ky konstatim nuk është i vërtetë. Grupit të hetimit administrativ ju dorëzuan edhe foto të cilat po i bashkëlidhim për ti ri dorëzuar ku



evidentohen qartë në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe italisht kushtet e privatësisë. Gjithashtu asnjë mbledhje tjetër dokumentacioni me të dhëna personale nuk bëhet nga portali zyrtar <http://www.unizkm.al>. Edhe kur dorëzohen dokumente në dorë për pjesëmarrje në konkurse për vende të lira pune, dorëzuesit i jepet një deklaratë për kushtet e përdorimi dhe ato të privatësisë. Prandaj këtë konstatim e kundërshtojmë si të pavërtetë dhe tendencioz.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*" është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 16/03/2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi provat e administruara gjatë hetimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit dhe rikuperimin e shkeljeve të paraqitura në shkresën nr. 211/2 Prot. datë 17/02/2017, konkludon:

Në lidhje me pretendimin e tretë të paraqitur në shkresën nr. 211/2 Prot. datë 17/02/2017 nga kontrolluesi Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*", konkludoj se kontrolluesi është në shkelje të nenit 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar - "*1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...*"

Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit online në internet, ka detyrim që të publikojë "*Politikat e Privatësisë*", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash, realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Publikimi i "*Politikave të Privatësisë*" në portalin zyrtar të kontrolluesit, përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe ka reaguar në mënyrë të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 18 dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

#### REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Universiteti Katolik "*Zoja e Këshillit të Mirë*" të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën "*Politikat e Privatësisë*";

2. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryhen plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
3. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 28.3/2017

**BESNIK DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**

